

## S H E N I M E T      S H P J E G U E S E

### **1 Informacion i përgjithshëm**

DITEKO SH.P.K është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar datë 07 Shtator 2009, në përputhje me Administrator i shoqërisë është z. Shkelqim Golli. Selia e shoqërisë ndodhet në Rr. 'Donika Kastrioti' Nr.4, Tiranë. Ortakët e shoqërisë janë:

- 1- GJOKA KONSTRUKSION sh.a, zotërues i një kuote me vlerë 50% të kapitalit
  - 2- ME-AJ Energy sh.p.k, zotërues i një kuote me vlerë 35% të kapitalit
  - 3- PERXHOLA sh.p.k, zotërues i një kuote me vlerë 5% të kapitalit
  - 4- 2 T sh.p.k, zotërues i një kuote me vlerë 10% të kapitalit
- Kapitali i regjistruar i shoqërisë është 377.766.000 Lekë.

Në 31 Dhjetor 2019 shoqëria ka 43 punonjës. (31 Dhjetor 2018, 43 punonjës)

### **2 Bazat e përgatitjes së Pasqyrave Financiare**

#### **2.1 Deklarata e pajtueshmërisë**

Pasqyrat Financiare janë përgatitur në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara dhe Ligjin Nr. 9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar.

#### **2.2 Bazat e matjes**

Pasqyrat Financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

#### **2.3 Parimi i vijimësisë**

Pasqyrat Financiare janë përgatitur mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

#### **2.4 Monedha funksionale dhe e paraqitjes**

Pasqyrat Financiare janë paraqitur në Lekë, e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

#### **2.5 Vlerësime dhe gjykime**

Përgatitja Pasqyrave Financiare në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit, kërkon që Drejtimi të bëj gjykimet, vlerësimet dhe supozimet të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë si pasojë e këtyre vlerësimeve. Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël nijhen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.

#### **2.5.1 Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme**

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pamundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në cregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshmë të termave të pagesës së konsumatorëve. Menaxhimi vlerëson në fund të cdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

### **3 Politikat Kontabël**

Politikat Kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

#### **3.1 Transaksionet në monedhë të huaj**

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe Detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi/humbja nga këmbimi është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato matën me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit në datë 31 Dhjetor 2019 dhe 31 Dhjetor 2018 jept si më poshtë:

Kursi i këmbimit	31/12/2019	31/12/2018
EUR/LEKË	121.77	123.42
USD/LEKË	108.64	107.82



### **3.2 Instrumentat Financiarë**

Instrumentat Financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme. Instrumentat Financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus cdo kosto transaksi që lidhet me to. Për instrumentat e mbajtur me vlerën e drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten sic përshkruhet më poshtë:

Një instrument finansiar njihet nëse shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare cregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivit finanziar ose kur shoqëria transferon aktivin finanziar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve finanziare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare cregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anullohen.

*Mjetet monetare dhe ekuivalentë e tyre*

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në bankë.

*Llogari të arkëtueshme*

Llogatitë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjëndje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitet financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij finansiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provisionit llogaritet si diferençë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

*Llogari të pagueshme*

Llogaritë e pagueshme dhe të tjera janë deklaruar me vlerën e drejtë dhe më pas me koston e tyre të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

*Huatë*

Huatë janë njohur fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, me shpenzime interesit të njohura bazuar në normën efektive. Norma efektive e interesit është norma që skonton saktësisht vlerat e ardhshme të parasë përgjatë jetgjatësisë së planifikuar të detyrimit finanziar, ose kur është e përshtatshme, për një periudhë më të shkurtër vlerën e mbetur neto nga njohja fillestare.

*Vlera e drejtë*

Vlerat e drejta të përllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

*Të tjera*

Instrumenta të tjera jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur cdo humbje nga zhvlerësimi.

*Zhvlerësimi i aktiveve finanziare*

Një aktiv finansiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se disa ngjarje kanë efekt negativ në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivit. Zhvlerësimi llogaritet si diferençë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhme të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera finansiare zhvlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

### **3.3 Inventarët**

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për të sjellë inventarin në vëndin dhe kushtet ekzistuese. Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme.

### **3.4 Aktive afatgjata materiale**



Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejtme blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, cdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitit në gjendje pune, si dhe kostot e emtimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në aktivit në proces dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitit kur përfundon ndërtimi i tij, ku aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në rastet kur pjesë të një aktivitit afatgjat material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zera të ndryshëm të aktiveve afatgjata materiale. Fitimet/humbjet nga shitjet, nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

#### *Amortizimi*

Amortizimi është llogaritur mbi vlerën e amortizueshme, e cila është kostoja e aktivitit duke zbritur vlerën e mbetur. Amortizimi njihet me normat si më poshtë në bazë të vlerës së mbetur.

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Ndërtesa dhe instalime	Vlera e mbetur	5%
Makineri dhe pajisje	Vlera e mbetur	20%
Mjete transporti	Vlera e mbetur	20%
Mobilje e pajisje zyre	Vlera e mbetur	20%
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25%

#### *Cregjistrimi*

Një zë i aktiveve afatgjata materiale cregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo kur nuk priten përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerra e tij jashtë përdorimit.

### 3.5 Kostot e huamarrjes

Kostot e huave të lidhura direkt me blerjen, ndërtimin/prodhimin e aktiveve i shtohen kostos së këtyre aktiveve. Kostot e huamarrjes kanë të bëjnë me interesin dhe kosto të tjera që janë bërë nga një shoqëri në lidhje me marrjen e fonave. Të gjitha kostot e tjera njihen si të ardhura/shpenzime në periudhën kur ato kanë ndodhur.

### 3.6 Të ardhurat

Të ardhurat nga shërbimet regjistrohen sipas masës së realizimit të tyre dhe lidhjes që ato kanë me ushtrimin e mbyllur kontabël, pavarësisht nëse arkëtimi i tyre apo i një pjese prej tyre do të ndodhë në një ushtrim pasardhës. Të ardhurat nga interesi regjistrohen në momentin e maturimit të tyre.

#### *Kontratat e ndërtimit*

Të ardhurat nga kontratat e ndërtimit përbëhen nga vlera fillestare për të cilën është rënë dakort në kontratë dhe (a) shuma e variacioneve për punën e kontraktuar; (b) pretendimet dhe (c) pagesat stimuluese të njoitura në atë masë në të cilën ato mund të konsiderohen si të ardhura dhe vlerësohen në mënyrë të besueshme.

Kur rezultatet e një kontrate ndërtimi mund të vlerësohen me besueshmëri, të ardhurat dhe kostot e lidhura me kontratën e ndërtimit do të njihen si të ardhura dhe shpenzime respektivisht me fazën e realizimit të punimeve në datën e bilancit, e njojur kjo si metoda e përqindjes së realizimit. Përqindja e realizimit është llogaritur mbi bazën e përqindjes së kostove faktike në datën e bilancit me kostot totale të vlerësuara të kontratës. Sipas kësaj metode, të ardhurat e kontratës krahasohen me kostot që janë kryer për të arritur në këtë fazë të realizimit të kontratës, duke rezultuar në raportimin e të ardhurave, shpenzimeve dhe fitimit që i atribuohen pjesës së punës së kryer. Të ardhurat e kontratës njihen si të ardhura dhe kostot njihen si shpenzime në Pasqyrën e të Ardhura Shpenzime në periudhën kontabël në të cilën është realizuar puna. Metoda të tjera të njoftes janë Njofta bazuar në volumin e punimeve me cmimë të përcaktuara.

### 3.7 Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillim të qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesavetë qirasë në datën e blerjes

### 3.8 Përfitimet e punëmarresve

Shoqëria paguan kontributet shoqërore e shëndetsore për punëmarresit, që sigurojnë më pas përfitime për pensione. Kontributet e shoqërisë në planin e përcaktuar të kontributeve të pensionit njihen si shpenzim i përfitimit të punonjësve në të ardhura dhe shpenzime në periudhat gjatë të cilave kryhen shërbimet nga të punësuarit.

### 3.9 Tatimi mbi fitimin



Tatimi fitimi i viti përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përvèc rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital. Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatushëm të viti, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe cfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2019 është 15% (2018, 15%). Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferençën e tatimit mbi fitimin të pagueshëm në periudhat e ardhshme, i cili përllogaritet për të evidentuar diferençat e përkohshme që krijojnë për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferençën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore. Gjëndjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferençat e përkohshme do të anullohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet. Aktivet tatimore të shtyra për diferençat e përkohshme të zbritshme regjistrohen aq sa është e mundshme që fitimi i tatushëm në të ardhmen të mund të përdoret për këto zbritje.

### 3.10 Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjeter, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjeter. Për qëllime të përgatitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë konsiderohen si palë të lidhura.

### 3.11 Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Aktivet dhe Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënimë të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët dhe gjithashtu për aktivet ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike .

#### 4 Mjetet monetare

Mjetet monetare në arke dhe në bankë detajohen si më poshtë më 31 Dhjetor 2019 dhe 31 Dhjetor 2018:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Gjëndje në Bankë	98,570,273	4,664,980
Gjëndje në Arkë	55,161	60,666,681
	<b>TOTALI</b>	<b>98,570,273</b>

#### 5 Të drejta të arkëtueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Klientë	166,397,596	35,982,447
<i>Kjo vlera paraqet shitjen e muajit Dhjetor 2019, faturuar dhe arketuar në Janar 2020</i>		

#### 6 Nga njësitë ekonomike brenda grupit:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Hua afatshkurtër ndaj Gjoka Konstruksion sh.a	13,100,000	-
<b>7 Të drejta të tjera të arkëtueshme</b>	<b>31 Dhjetor 2019</b>	<b>31 Dhjetor 2018</b>
Tatim fitimi	25,067,184	-
Bllokim fondi bankar në favor inst.arkelologjisi	304,000	304,000
Teprice doganore	5,399	
<b>8 Shpenzime të shtyra</b>	<b>31 Dhjetor 2019</b>	<b>31 Dhjetor 2018</b>
Interesat e kapitalizuara të kredive	539,704,598	446,573,682
Shpenzime afatgjata qeraje per tokat	21,034,494	21,843,513
Taksa vendore nga komuna	-	1,971,956
Detyrime kontrolli	-	1,838,208
	<b>560,739,092</b>	<b>472,227,359</b>



**9 Aktive afatgjata materiale**

Kosto	Toka, Ndërtesa	Makineri e pajisje	Pajisje zyre	Totali
Gjendja më 01/01/2019	7,234,626,547	414,027	322,667	7,235,363,241
Shtesa			1,773,647	1,773,647
Pakësimë				
Gjendja më 31/12/2019	7,234,626,547	414,027	2,096,314	7,237,136,888
Amortizim i akumuluar				
Gjendja më 01/01/2019	490,270,164	46,092	64,533	490,380,788
Amortizim i viti	337,217,819	73,587	267,803	337,559,209
Pakësimë				
Gjendja më 31/12/2019	827,487,983	119,679	332,336	827,939,997
Vlera neto kontabël				
Gjendja më 01/01/2019	6,744,356,383	367,936	258,134	6,744,982,453
Gjendja më 31/12/2019	6,407,138,564	294,348	1,763,978	6,409,196,891

**12 Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit** 31 Dhjetor 2019 31 Dhjetor 2018  
Furnitorë 1,642,317,540 2,052,708,320

**13 Detyrime tativore** 31 Dhjetor 2019 31 Dhjetor 2018  
Detyrime per Tatim Fitimin 36,507,197  
Detyrime për sigurimet shoqërore&shëndetsore 570,615 642,186  
Tatim mbi të ardhurat personale 113,088  
Tatimi në Burim 2,100 77,100  
T.V.SH 15,928,402 1,129,987  
T.V.SH për t'u rregulluar (deklarimi paraprak i faturës së shitjes së energjisë Dhjetor19)

**15 Detyrime afatgjata** 31 Dhjetor 2019 31 Dhjetor 2018  
Detyrime ndaj institucioneve të kredisë 4,266,939,125 3,989,408,479  
Kredi ndaj BKT, Nr. 3537 Rep. 909 Kol Datë 11.07.2014  
Kredi ndaj BKT, Nr. 5697 Rep. 1096 Kol Datë 07.10.2015  
Kredi ndaj BKT, Nr. 13477 Rep. Kol 313 Datë 03.03.2015  
Tre kreditë e sipërpërmendura janë riامenduar me një kontratë të re kredie Nr.2676 Rep. 1808 Kol Datë 05.08.2019 me Normë interesë = 5.5%, Afati 8 Vjet (Gusht 2028)

**16 Kapitali**  
Kapitali themeltar i shoqërisë është 377.766.000 Lekë

	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
Numri i kuotave	4	4
Shoqëria Gjoka Konstruksion sh.a zotëruese e 1 kuote me vlerë 50% të vlerës së kapitalit		
Shoqëria Me-Aj Energy sh.p.k zotëruese e 1 kuote me vlerë 35% të vlerës së kapitalit		
Shoqëria 2T sh.p.k zotëruese e 1 kuote me vlerë 10% të vlerës së kapitalit		
Shoqëria Perxhola sh.p.k zotëruese e 1 kuote me vlerë 5% të vlerës së kapitalit		

Vlera nominale në Lekë	377,766,000	377,766,000
Kapitali i nënshkruar	<u>377,766,000</u>	<u>377,766,000</u>
Rezervat e tjera	393,272,514	652
Fitimi i viti ushtrimor	198,186,508	393,271,861



<b>18</b>	<b>Analiza dhe rakordimi i shitjeve</b>	<b>31 Dhjetor 2019</b>	<b>31 Dhjetor 2018</b>
	<b>Totali i të ardhurave sipas FDP-ve të TVSH-</b>	<b>757,740,968</b>	<b>1,499,020,750</b>
	Të ardhura nga shitja e energjisë elektrike	757,740,968	1,499,020,750
	<i>Rregullime</i>		
	Të ardhura të deklaruara paraprakisht për shitje realizuar 2019, fature e vitit 2020	141,014,912	
	Të ardhura nga këmbimet valutore	6,575,486	74,423
	<b>Totali i të ardhurave sipas FDP-së së</b>	<b>905,331,366</b>	<b>1,499,095,173</b>
	<b>Tatimit mbi Fitimin</b>		
<b>19</b>	<b>Analiza dhe rakordimi shpenzimeve</b>		
	<b>Lëndë e parë &amp; materialet e konsumueshme</b>	<b>31 Dhjetor 2019</b>	<b>31 Dhjetor 2018</b>
	Lëndë e parë	2,097,400	99,965,029
	Ndryshim gjendje inventar	-	-
	<b>Shpenzimet e personelit</b>	<b>31 Dhjetor 2019</b>	<b>31 Dhjetor 2018</b>
	Paga	25,186,132	21,795,613
	Sigurime shoqërore e shëndetsore	4,070,158	3,456,368
	<b>Shpenzime konsumi dhe amortizimi</b>	<b>31 Dhjetor 2019</b>	<b>31 Dhjetor 2018</b>
	Amortizim i vitit	337,559,210	292,344,570
	<b>Shpenzime të tjera të shfrytëzimit</b>	<b>31 Dhjetor 2019</b>	<b>31 Dhjetor 2018</b>
		42,307,888	385,023,509
	<b>Shpenzime të tjera financiare</b>	<b>31 Dhjetor 2019</b>	<b>31 Dhjetor 2018</b>
	Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngashme	257,542,716	230,986,798
	Shpenzime të tjera financiare	3,059,420	2,828,821
	Shpenzimet e interesit Jane 219,775,272 Lek Interesa te paguar gjate vitit dhe 37,767,344 Leke intesa te Grace period amortizuar sipas jetegjatesise se kredise.		
	<b>Totali i shpenzimeve sipas FDP-së së</b>	<b>671,822,924</b>	<b>1,036,400,708</b>
	<b>Tatimit mbi Fitimin</b>		
	<b>Rakordim i Blerjeve me Librin e Blerjes</b>		
	Importe me TVSH	644,811	
	Blerjet pa TVSH e me TVSH të pa zbritëshme	18,654,479	
	Blerje me TVSH të zbritëshme	8,500,217	
	<u>Autongarkesë TVSH në blerje</u>	<u>3,918,205</u>	
	<b>Shuma e blerjeve të raportuara me F.D.P</b>	<b>31,717,712</b>	
	<b>Nga këto sipas destinacionit</b>		
	Për Aktive Afatgjata Materiale	1,773,647	
	Për Materiale	2,097,400	
	Shpenzim për Fe Koncessionare	15,154,819	
	Autongarkesë për shpz mirmbajtje HEC	3,918,205	
	Për shërbimë të tjera, nënkontraktor, transporte	8,757,125	
	<u>Deklaruar Taksat doganore</u>	<u>16,515</u>	
	<b>Shuma e blerjeve sipas destinacionit</b>	<b>31,717,712</b>	
	<b>Nga këto, janë përfshirë në shpenzime :</b>		
	<u>Për Blerje mallra</u>	<u>2,097,400</u>	
	<u>Për blerje shërbime, punime nga të tretë</u>	<u>8,757,125</u>	
	<b>Shpenzime Blerje Shërbime</b>	<b>10,854,525</b>	
	<b>Nga të cilat</b>		
	a) Kosto e mallrave të blera, të raportuara në Librin e Blerjeve	2,097,400	



b) Ndryshimi i gjendjes së mallrave (+/-)		
Totali (a+b)	2,097,400	
Zëri : "Shpenzime materiale" sipas Pasqyrës së Performancës	(2,097,400)	
Diferenca	-	
a) Shpenzime shërbime, të raportuara në Librin e Blerjeve	27,899,379	
b) Shpenzime shërbime, të pa raportuara në Librin e Blerjeve	14,408,509	
Totali (a+b)	42,307,888	
Zëri "Shpenzime të tjera" sipas Pasqyrës së Performancës	(42,307,888)	
Diferenca	(0)	
<i>Detajimi "Shpenzime të tjera" të shfrytëzimit me faturë</i>		
Trajtime të përgjithshme	7,547,655	
Blerje Energji, Internet	365,664	
Shërbime konsulencë, Studime, Noterizime	1,286,266	
Shërbime transporti, Doganore	27,515	
Sigurim i vepres	3,348,294	
Shpenzime te tjera personeli	80,360	
Publicitet	88,806	
Fee Koncessionare 2%	15,154,819	
<i>Detajimi Shpenzime të tjera të shfrytëzimit pa faturë</i>		
Taksa e tarifa vendore	6,123,342	
Qira	977,019	
Tarife per Entin Rregulator	544,777	
Shpenzime të panjohura	1,971,117	
Kuota e shpenzimeve te periudhave te ardhme	1,971,956	
Fee Koncessionare 2% Dhjetor 2019, Faturuar J:	2,820,298	
<b>Shuma "Shpenzime të tjera" sipas zërave</b>	<b>42,307,888</b>	

20	Shpenzimet e tatum fitimit	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
	Fitimi para tatumit	233,508,442	462,694,465
	Shpenzime të panjohura	1,971,118	122,893
	Fitimi para tatumit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	235,479,560	462,817,358
	Tatum Fitimi 15%	<u>35,321,934</u>	<u>69,422,604</u>

## 21 Angazhime dhe pasiguri

Cështjet gjyqësore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesit të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto cështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Më 31 Dhjetor 2019 Shoqëria nuk ka asnjë cështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkoj rregullime të këtyre Pasqyrave Financiare.

Detyrime tatumore

Librat e shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatumore për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019. Si rrjedhojë detyrimet tatumore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatumore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.

## 22 Ngjarjet pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

Për drejtimin e njësisë ekonomike

ADMINISTRATORI

Shkelqim Golli

